



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 25 Shkurt 2022

Nr: 101

V E N D I M

P Ë R

**SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË INSTITUTIT DEMOKRATIK KOMBËTAR (NDI)  
DHE KOMITETIT SHQIPTAR TË HELSINKIT (KShH) PËR VËZHGIMIN E  
ZGJEDHJEVE TË PJESSHME PËR KRYETAR BASHKIE, TË DATËS 6 MARS 2022**

Sot, më datë 25.2.2022, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi kërkesën e:

**KËRKUES:**

1. NDI Albania, me seli në Tiranë, Rruga “Janosh Huniadi” dhe përfaqësuese zj. Ana Kovacevic;
2. Komiteti Shqiptar i Helsinkit, me seli në Tiranë, Rruga “Brigada e VIII” dhe përfaqësuese zj. Erida Skëndaj.

**OBJEKTI:**

Kërkohet akreditimi si vëzhgues afatshkurtër dhe afatgjatë për vëzhgimin e zgjedhjeve të pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022.

**BAZA LIGJORE:**

Nenet 6, 7, e 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe udhëzimi nr. 2, datë 2.2.2021 “Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, mediave dhe subjektet zgjedhore”,

**VËREN:**

Instituti Demokratik Kombëtar (NDI) i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën si dhe dokumentacionin përkatës për akreditimin e 6 (gjashtë) vëzhguesve afatshkurtër si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5, të



Kodit Zgjedhor. NDI është subjekt i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje të përcaktuar në nenin 6, pika 2, të Kodit Zgjedhor.

Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH) i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën si dhe dokumentacionin përkatës për akreditimin e 11 (njëmbëdhjetë) vëzhguesve afatgjatë dhe 27 (njëzet e shtatë) vëzhguesve afatshkurtër si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5, të Kodit Zgjedhor. KShH është subjekt i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje të përcaktuar në nenin 6, pika 2, të Kodit Zgjedhor.

### **PËR KËTO ARSYE**

Bazuar në nenet 6, 7, e 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe udhëzimin nr. 2, datë 2.2.2021 “Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, mediave dhe subjektet zgjedhore”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

### **V E N D O S I:**

1. Akreditimin si vëzhgues afatshkurtër për vëzhgimin e zgjedhjeve të pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022, të 6 (gjashtë) vëzhguesve afatshkurtër të NDI Albania, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Akreditimin si vëzhgues afatgjatë dhe afatshkurtër për vëzhgimin e zgjedhjeve të pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022, të 11 (njëmbëdhjetë) vëzhguesve afatgjatë dhe 27 (njëzet e shtatë) vëzhguesve afatshkurtër të KShH, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga shpallja e tij, në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

